



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
SENATI AKADEMIK

Nr. 2386 prot.
2

Elbasan, më 09./11./2021

VENDIM

Nr. 28 datë 09.11.2021

**"PËR
RIORGANIZIMIN E DY NJËSIVE BAZË NË FAKULTETIN E SHKENCAVE HUMANE"**

Në mbështetje të nenit 30 pika 6, nenit 38 gërma "ë" të Ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 9 gërma "k" të Statutit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", me propozim të Dekanatit të Fakultetit të Shkencave Humane, pas miratimit të Bordit të Administrimit me Vendim nr. 45 datë 02.11.2021, Senati Akademik

V E N D O S I:

1. Në Fakultetin e Shkencave Humane, njësia bazë e emërtuar "Departamenti i Gjuhëve Angleze dhe Gjermane" dhe njësia bazë e emërtuar "Departamenti i Gjuhëve Italiane dhe Frënge" riorganizohen në një njësi bazë të emërtuar "Departamenti i Gjuhëve të Huaja".
2. Në Fakultetin e Shkencave Humane mbyllet njësia bazë e emërtuar "Departamenti i Gjuhëve Angleze dhe Gjermane".
3. Në Fakultetin e Shkencave Humane mbyllet njësia bazë e emërtuar "Departamenti i Gjuhëve Italiane dhe Frënge".
4. Njësia bazë e re e emërtuar "Departamenti i Gjuhëve të Huaja" do të jetë përgjegjëse për programet e studimit të ofruara nga Departamenti i Gjuhëve Angleze dhe Gjermane dhe Departamenti i Gjuhëve Italiane dhe Frënge.
5. Dokumentacioni i Departamentit të Gjuhëve Angleze dhe Gjermane dhe Departamentit të i Gjuhëve Italiane dhe Frënge do të administrohet nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja.
6. Ngarkohet Dekani i Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, për zbatimin e këtij vendimi.
7. Ky vendim t'i njoftohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Prof.Dr.Skender TOPI